



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 18.12.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin ***“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin
nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”***

Drejtuar: Seancës plenare

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 18.12.2018, në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektligjin *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.108/2014, “Per Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”*.

I. Qëllimi dhe objektivi i projektligjit:

Projektligji *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar”*, synon ndryshimin e ligjit organik të Policisë së Shtetit, me qëllim përmirësimin e tij, nëpërmjet krijimit të një policie më aktive dhe eficiente në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti.

Gjithashtu, propozimet e projektligjit, në veçanti ndryshimet që lidhen me kriteret e pranimit, të emërimit, procedurat e fitimit të gradave, kanë si qëllim rritjen e parametrave të rendit dhe të sigurisë publike.

Ky projektligj është pjesë e reformës në Policinë e Shtetit, e cila është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, pasi prioriteti i qeverisë për vitet në vazhdim është rritja e parametrave të rendit e sigurisë publike, forcimi i mëtejshëm i luftës kundër krimit në përgjithësi e atij të organizuar në veçanti, si dhe luftës kundër terrorizmit.

Aktualisht, procesi i rekrutimit, i sistemit të karrierës dhe i gradimeve, përfshirë dhe emërimet e personelit të policisë ka paraqitur mangësira dhe joefiçencë. Sistemi i pranimit dhe i emërimit, i bazuar në ecurinë në karrierë vetëm në strukturat e Policisë së Shtetit nuk i përgjigjet problematikave, në veçanti domosdoshmërisë së brendshme për një luftë sa më efikase kundër krimit të organizuar, terrorizmit, korrupsionit dhe përmirësimit të standardeve të rendit e të sigurisë. Lufta ndaj këtyre fenomeneve kërkon jo vetëm eksperiencën policore por edhe ekspertizën e duhur në fusha të caktuara.

Për këtë qëllim, projektligji parashikon mundësinë e pranimit në Akademinë e Sigurisë edhe të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që në përfundim të kualifikimit përkatës u jepet grada policore “Nënkomisar”. Gjithashtu, është propozuar rritja e përqindjes së pranimit në funksione të veçanta, që kërkojnë njohuri specifike, të cilat nuk përfitohen në Akademinë e Sigurisë, nga 1 % e limitit të përgjithshëm organik të Policisë së Shtetit, në 3 %.

Po në funksion të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, si prioritete kyçe të Policisë së Shtetit, është vlerësuar i nevojshëm pranimi edhe nga Forcat e Armatosura. Në këtë rast, është parashikuar edhe ekuivalentimi i gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradat e Policisë së Shtetit, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Projektligji propozon ndryshime edhe në kriteret e emërimit të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë si dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm. Është vlerësuar që kriteri i përvojës (15 vite për drejtorin e Përgjithshëm dhe 12 vite për Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm) të mos kufizohet vetëm në strukturat policore, por të njihet edhe eksperiencia në strukturat e tjera të sigurisë kombëtare.

Projektligji propozon, gjithashtu, ndryshime që synojnë rregullimin e procedurës së fitimit të gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” duke parashikuar që fitimi i gradës bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimimit/trajnimit. Ndryshimet prekin, gjithashtu, rastet e lirimit nga policia, duke shtuar si rast lirimi edhe refuzimin e pajisjes me certifikatë përkatëse të sigurisë.

Përparësitë që do të sjellë miratimi i këtij projektligji mund të përmbliidhen, kryesisht, si më poshtë:

- Fuqizimin e strukturave operacionale policore;
- Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit;
- Luftën pa kompromis dhe ndëshkimin e ashpër penal ndaj grupeve dhe/ose organizatave kriminale, si dhe grupeve me agjenda ekstremiste të dhunshme dhe terroriste;

- Përforcimin e sigurisë publike dhe sigurimin e shërbimeve efikase e cilësore ndaj qytetarëve;

- Përforcimin e kontrollit në kufi dhe përmirësimin e shërbimit kufitar, si kusht për të garantuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 i projektligjit parashikon ndryshimin e nenit 6, të ligjit, duke ndryshuar pikën 16 të tij. Konkretisht, ky nen përcakton që punonjës policie është personi i emëruar në strukturat e policisë pas përfundimit të arsimit/kualifikimit përkatës dhe mban gradë policore.

Neni 2, i projektligjit, ndryshon shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit, duke përcaktuar që kriteri i “15 vite përvojë” për emërimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të jetë jo vetëm në polici por edhe në strukturat e tjera të sigurisë kombëtare.

Neni 3, i projektligjit, në të njëjtën linjë si neni i mësipërm ndryshon germën “b” të pikës 1, të nenit 14, duke përcaktuar që kriteri i “12 vite përvojë” për emërimin e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të jetë jo vetëm në strukturat policore, por edhe nga strukturat e tjera të sigurisë kombëtare.

Neni 4 ndryshon pikën 1, të nenit 19, të ligjit, duke shtuar që, Policia e Shtetit organizohet mbi bazë shërbimi të profilizuar në Policinë Kriminale, Policinë Për Sigurinë Publike dhe Policinë për Kufirin dhe Migracionin. Kategoritë e profilizuara të Policisë së Shtetit dallojnë midis tyre nga arsimi, kualifikimi, simbolet, detyrat dhe përgjegjësitë që ushtrojnë.

Neni 5 ndryshon nenin 38, të ligjiit “Kriteret për pranimin në Akademinë e Sigurisë”. Është shtuar si kriter pranimi edhe “mospërfundimi nga strukturat e tjera të sigurisë kombëtare”, si dhe të plotësojë standardet dhe kriteret e tjera të veçanta të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga ministri i Brendshëm. Gjithashtu, po në këtë nen është propozuar që për nevoja të Policisë së Shtetit pranohen në Akademinë e Sigurisë shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 38. Kandidati që përfundon me sukses kualifikimin përkatës pranohet në Policinë e Shtetit dhe i jepet grada policore “Nënkomisar”.

Neni 6 ndryshon pikën 4, të nenit 40, duke propozuar rritjen e numrit të personave që mund të pranohen në funksione të veçanta, ku kërkohen njohuri specifike, nga 1 për qind në 3 për qind të limitit të përgjithshëm organik të Policisë së Shtetit.

Neni 7 shton nenin 40/1 “Pranimi nga radhët e Forcave të Armatosura”. Kjo dispozitë parashikon që për plotësimin e nevojave të veçanta mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gjithsesi, pranimi bëhet vetëm në rast se respektohen kriteret e përgjithshme të pranimi, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 38, të ligjit. Pranimi realizohet mbi bazë marrëveshjeje dypalëshe, ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, ku përcaktohen kuotat dhe strukturat nga ku do të pranohen.

Pranimi bëhet vetëm pas nxjerrjes në lirim të ushtarakëve nga autoritetet kompetente të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe realizohet mbi baza konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike. Në këtë rast, njihet vjetërsia e shërbimit dhe bëhet ekuivalentimi i gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradat e Policisë së Shtetit, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8 parashikon një shtesë në pikën 2, të nenit 46, të ligjit, duke shtuar si rast lirimi nga policia edhe refuzimin për pajisje me certifikatë përkatëse të sigurisë.

Neni 9 parashikon një shtesë në pikën 1.1, të nenit 53, të ligjit, duke shtuar si kriter për marrjen e gradës “Inspektor i dytë” dhe “Inspektor i parë”, jo vetëm vjetërsinë në punë por edhe funksionin.

Neni 10 ndryshon pikën 1 të nenit 54. Konkretisht, parashikohet rregullimi i procedurës së fitimit të gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimit/trajnimit.

Neni 11 ndryshon shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 55, duke shtuar si kriter për fitimin e gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” edhe përfundimin e arsimit të lartë.

Neni 12, i projektligjit, ndryshon nenin 57, konkretisht pikën 3, të tij, duke përcaktuar se kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70 për qind e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit, si dhe shton pikën 4, e cila parashikon që përbërja e komisioneve të gradimit dhe ankimimit, rregullat e procedurat e zhvillimit dhe të vlerësimit të kandidatëve në fazat e testimit përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 13 ndryshon titullin e nenit 58 të ligjit, si dhe heq nga përmbajtja e tij fjalët “... fitimin e gradës përkatëse ...”.

Neni 14 i projektligjit ndryshon pikën 3, të nenit 59, duke rregulluar procesin e dhënies së gradës pas përfundimit të programit të arsimit/trajnimit përkatës, si dhe shfuqizon

pikën 4, të këtij neni, me qëllim harmonizimin e kësaj dispozite me pikën 4, të shtuar në nenin 57 të ligjit.

Neni 15 shton nenin 59/1, i cili parashikon procedurën për dhënien e gradës në përfundim të procesit të testimit dhe të arsimimit/kualifikimit.

Neni 16 propozon disa ndryshime në nenin 96 të projektligjit, duke zëvendësuar masën disiplinore “ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj” me masën “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”. Gjithashtu, është propozuar ndryshimi i afatit të shuarjes së masës disiplinore “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim” nga 2 vjet në 6 muaj nga njoftimi i masës, si dhe për masat “shtyrje e afatit të gradimit” ose “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, është parashikuar 1 vit nga mbarimi i afatit.

Neni 17 parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore.

Neni 18 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit.

III.DISKUTIME NË KOMISIONIN E SIGURISË KOMBËTARE

Për prezantimin e projektligjit në komision ishin të pranishëm Ministri i Brendshëm Z.Sandër Lleshaj, Zëvendësministrja e Brendshme Znj.Rovena Voda dhe përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes.

Në fjalën e tij Z.Lleshaj u shpreh se në vitin e ardhshëm përpara Ministrisë së Brendshme shtrohen sfida dhe detyra shumë të mëdha, që lidhen me dy sektorë të rëndësishëm. E para, me luftën kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimit në ekonomi në veçanti. Dhe së dyti, në përmbushjen e një axhende shumë intensive detyrash dhe përgjegjësish në kuadër të hapjes së negociatave që priten në vitin e ardhshëm, proces ky i cili e ngarkon Ministrinë e Brendshme me një barrë jashtëzakonisht të madhe përgjegjësish që duhen kryer kryesisht në përmbushje të kërkesave që parashtrohen në Kapitullin 24.

Më tej Z.Lleshaj theksoi se ndryshimi në ligjin “Pë Policinë e Shtetit” bëhet për disa arsye:

Arsyeja e parë që lidhet me këtë ka të bëjë me mosfunksionimin e Akademisë së Sigurisë ose Akademisë së Policisë, për një periudhë shumë të gjatë. Akademia e Sigurisë u hap në vitin 2015 pas një periudhe 10-vjeçare mosfunksionimi. Si pasojë e kësaj, Policisë së Shtetit i mungojnë sot një numër i konsiderueshëm oficerësh, kryesisht në nivelin “nënkomisar” që nënkupton nivelin bazë të oficerëve të Policisë së Shtetit por edhe në të

gjithë hierarkinë e gradave të kësaj organizate. Në të gjitha kategoritë e gradave ka një mangësi që shkon tek një mesatare rreth 30%, gjë që paraqet një problem shumë serioz.

Në nivelin e drejtuesit të lartë janë mangët 46% e gradave, në nivelin drejtues janë mangët 30% e gradave, në nivelin kryekomisar janë mangët 36%, në nivelin komisar janë minus 38%, në nivelin nënkomisar janë minus 28%.

Për t'u fokusuar vetëm tek niveli bazë, tek nënkomisarët; nga 1482 nënkomisarë që duhet të ketë Policia e Shtetit sot, ajo ka vetëm 1167 ose 25% minus.

Nëse do të ndiqen procedurat aktuale, do të duhen të paktën katër vjet që mund të fillohet të plotësohen boshllëqet e sistemit. Pra do të duhet që të për zgjidhen kandidatët e rinj për Akademinë e Sigurisë, të cilët pasi të kalojnë me sukses programin e arsimimit, të arrijnë të emërohen si nënkomisarë në Policinë e Shtetit. Por katër vjet pritje, me një mangësi të ndjeshme në nivelin bazë të strukturës, janë jashtëzakonisht shumë.

Nevoja për një intensitet të shtuar në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe kundër atij të organizuar në veçanti, kërkon kapacitete të plota të Policisë së Shtetit.

Në të vërtetë vendit tonë i duhen më shumë punonjës policie nga sa mundëson struktura aktuale. Por paradoksalisht ne kemi mangësi edhe në vetë strukturën minimaliste të Policisë së Shtetit, mangësi të cilat synohen të vihen në rrugën e zgjidhjes, me miratimin e ndryshimeve që ju propozojmë sot në këtë p/ligj i cili ka marrë vëmendjen tuaj sot.

Mandej Ministri i Brendshëm u fokusua mbi atë çfarë ndryshimet e propozuara parashikojnë ku katër çështjet themelore janë :

- Së pari, plotësim i boshllëqeve ekzistuese në nivelin bazë të piramidës së gradave të Policisë së Shtetit, pra në nivel “nënkomisar”.
- Së dyti, pasurim të nivelit të ekspertizës së Policisë së Shtetit me specialitete të munguara, të cilat Akademia e Sigurisë nuk i krijon, nuk i prodhon.
- Së treti, specializimin e kategorive të policisë, pra të Policisë Kriminale, të Policisë së Rendit, të Policisë së Kufirit dhe të Emigracionit.
- Së katërti hapja e një mundësie për pranimin e disa specialiteteve të veçanta nga FA, nga ushtarakët në radhët e policë. Gjithnjë bëhet fjalë për specialitete të cilat Policia e Shtetit, me kapacitetet e saj nuk i krijon dot.

Çështje të ngritura në komision ishin:

Ndryshimet më të rëndësishme lidhur me përfshirjen e ushtarakëve në strukturat e Policisë së Shtetit, janë parashikuar në nenin 7 të projektligjit. Në këtë nen parashikohet mundësia e pranimit në Policinë e Shtetit të ushtarakëve të FA-ve. Paragrafi 1 i këtij neni i referohet ushtarakëve të FA-ve, ku me përkufizim, sipas ligjit nr. 59/2014 mbi karrierën ushtarake, përfshihen: ushtarakët aktivë, ushtarakët në rezervë, studentët ushtarakë. Ligji nr. 59/2014 parashikon në mënyrë të detajuar kuptimin e secilës kategori. Përkufizime të ngjashme ofrohen edhe në ligjin për statusin e ushtarakut, ligj i cili prej disa vitesh përgatitet të ndryshojë duke integruar ndryshimet e realizuara në 2014 në ligjet e tjera themelore të FA-ve (pushtetet, karriera), përfshirë kuptimet e kategorive të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

Ndërkohë që paragrafi 2 i nenit 7 të projektligjit, i referohet pranimit në Policinë e Shtetit të ushtarakëve të shërbimit aktiv, të cilët përbëjnë vetëm një nga kategoritë e ushtarakëve të FA-ve. Ushtarakët e shërbimit aktiv, përfaqësojnë kategorinë aktualisht në detyrë të ushtarakëve që garantojnë funksionimin e FA-ve. Për vetë rëndësinë që paraqet kjo kategori, Kushtetuta ka parashikuar se ushtarakët e shërbimit aktiv, nuk mund të zgjidhen ose emërohen në asnjë detyrë tjetër shtetërore (neni 167/1), siç do të ishte rasti i rekrutimit në Policinë e Shtetit. Pra ushtaraku pjesë e kësaj kategorie, pikërisht për shkak të këtij parashikimi kushtetues, nuk mund të përfshihet në struktura të tjera shtetërore, që nuk janë ushtarake, përveçse nëse resht së qeni i tillë, dhe nga ushtarak aktiv bëhet *ushtarak në lirim ose në rezervë nga FA-të*.

b) Në këtë kuptim duhet sjellë në kujtesë ndryshimi themelor në terminologjinë e FA-ve, *të lirimimit nga detyra dhe lirimimit nga FA-të*, sipas të cilit, ushtaraku aktiv i liruar nga detyra vijon të mbetet i tillë, pasi mund dhe duhet të emërohet në struktura të tjera ushtarake. Ndërkohë që ushtaraku i liruar nga FA-të, pushon së qeni ushtarak aktiv duke u kategorizuar si ushtarak në rezervë/lirim. Ky aspekt është shumë i rëndësishëm, dhe duhet rregulluar me shumë kujdes në projektligj. Lëvizja përbrenda domainit ushtarak (lirimi dhe emërimi në detyrë) nënkupton procedurë e autoritete të ndryshme kompetente, nga lirimi/nxjerrja në rezervë nga domaini ushtarak/FA-të dhe kalimin në jetën/institucionet civile. Ky aspekt është shumë i rëndësishëm pasi nënkupton ndërveprimin e disa autoriteteve sipas llojit të lëvizjes (brenda domainit ushtarak, ose jashtë tij) dhe kategorive të ushtarakëve (këtu kemi parasysh kompetencat e Presidentit të Republikës sa i përket disa gjeneralëve në lëvizjen brenda domainit ushtarak dhe jashtë tij, si dhe kompetencat e Kryeministrit për një pjesë tjetër gjeneralësh). Këto përcaktime janë mëse të detajuara në ligjin për pushtetet dhe autoritet dhe në ligjin për karrierën ushtarake, dhe duhen patur parasysh në formulën e kalimit eventual të ushtarakut nga strukturat ushtarake në ato civile.

Këto përcaktime ndikojnë dhe marrëveshjen e parashikuar ndërministrorë për kuotat dhe strukturat prej nga do të rekrutohen ushtarakët për në Policinë e Shtetit, për shkak se

kompetencat e ministrit të Mbrojtjes mbi ushtarakët nuk janë të pakufizuara, përkudrazi.

Roli i ministrit të Mbrojtjes është mjaft i kufizuar lidhur me disa ushtarakë me grada madhore, të cilit mund të lëvizin jashtë FA-ve, vetëm me dekret të Presidentit. Një marrëveshje ndërministrorë lidhur me kuotat dhe strukturat ka shtrirje të kufizuar në përputhje me kompetencat që ministri i Mbrojtjes mund të ushtrojë në lirimin apo nxjerrjen në rezervë të ushtarakëve.

Sipas paragrafit 3 të nenit 7, pranimi në Policinë e Shtetit, bëhet pas nxjerrjes në lirim të ushtarakëve nga autoritetet kompetente. Këtu duhet saktësuar qartë se bëhet fjalë për lirim nga FA-të, dhe jo vetëm nga detyra. Lirimi nga FA-të nënkupton se ushtaraku nuk kualifikohet më si ushtarak aktiv, gjë që është në përputhje me parashikimin e nenit 167/1 të Kushtetutës mbi ndalimin e ushtarakëve aktivë për t'u emëruar në detyra të tjera shtetërore.

Duhet pasur parasysh se sipas vetë konceptit të Policisë së Shtetit, si organizëm civil që ndërvepron me civilët dhe bazuar në nenin 39 të ligjit për Policinë e Shtetit që i njeh statusin e nëpunësit civil punonjësit të Policisë së Shtetit, duhet që ushtaraku që do të rekrutohet në Policinë e Shtetit të ketë ndërprerë lidhjet më karrierën ushtarake dhe sidomos me statusin e ushtarakut, i cili është i papajtueshëm me përkufizim me statusin e civilit.

Rekomandimi që kalimi i ushtarakëve në Policinë e Shtetit të bëhet vetëm në rast nxjerrjeje në lirim/rezervë të tyre, siç u parashtrua më lart, bazohet edhe në parashikimin e ligjit nr. 64/2014 për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të FA-ve, që përcakton autoritetet përgjegjëse për drejtimin dhe komandimin e FA-ve, duke mos përfshirë në to MB apo drejtuesit e Policisë së Shtetit. Asnjë autoritet, që nuk është parashikuar në ligjin për pushtetet dhe autoritetet e FA-ve, nuk mund të ushtrojë kompetenca mbi ushtarakët aktivë.

Në projektligj nuk është e qartë se cilat janë *nevojat e veçanta* për rekrutimin e ushtarakëve në Policinë e Shtetit. Parashikimi i këtyre nevojave rekomandohet të bëhet me ligj, për të garantuar nivelin e duhur të ligjshmërie në përthithjen e komponentit ushtarak/me përgatitje ushtarake, në struktura të projektuara me thelb civil.

Nuk është e qartë nëse *pranimi për nevoja të veçanta* është i përhershëm apo i përkohshëm. Nuk do të rekomandohej kalimi i përkohshëm nga FA-të në Policinë e Shtetit, në vështrim të paqartësisë juridike që do të krijohej për funksionimin e FA-ve dhe për vetë pozicionin e ushtarakut.

Gjithashtu kalimi i përhershëm nga karriera ushtarake në atë civile, duhet të përputhet dhe me parashikime të qarta të përfitimeve që i mbeten ushtarakut pavarësisht kalimit. Ushtarakët përfitojnë një sërë të drejtash për shkak të statusit të tyre të posaçëm,

rregulluar në ligjin nr. 9210/2004. Ndërkohë që amendimet e propozuara në nenin 7 të projektligjit parashikojnë vetëm vjetërsinë në shërbim, por asgjë tjetër lidhur me përfitimet nga statusi i ushtarakut. Këto përfitime duhen parë krahasimisht me përfitimet e ngjashme të punonjësve të Policisë së Shtetit për të mos krijuar mbivendosje, por në të njëjtën kohë, as përkeqësim të përfitimeve të ushtarakëve.

Kalimi nga një strukturë ushtarake në një strukturë civile duhet të parashikojë gjithashtu periudha paraprake trajnimi/kualifikimi të ushtarakëve, lidhur me misionin dhe detyrat e përgjegjësitë e punonjësve të Policisë së Shtetit, pasi arsimimi, përgatitja, kualifikimet, apo stërvitjet e ushtarakëve janë përftuar për qëllime të mbrojtjes së pavarësisë së vendit e të rendit kushtetues, dhe jo për të përgatitur ushtarakun të ndërveprojë me civilët. Një kalim nga një strukturë në tjetrën, që nuk merr parasysh këtë përshtatje të domosdoshme të ushtarakut me detyrën e re, mund të rezultojë me pasoja të mosushtërimit të duhur të detyrës së ngarkuar.

Një tjetër çështje me rëndësi, lidhet me nevojën për të përcaktuar një limit të të rekrutimit nga FA-të ushtarakëve në Policinë e Shtetit. Ligji aktual për Policinë e Shtetit e krijon qartësisht premisën për të pranuar në funksione të veçanta edhe persona që nuk vijnë nga radhët e Policisë së Shtetit dhe për këtë në nenin 40 pika 4 të ligjit aktual parashikohet se:

“Numri i personave të pranuar, sipas këtij neni, nuk mund të jetë më shumë se 1 përqind e limitit të përgjithshëm organik të Policisë së Shtetit”.

Ministria sugjeron rritje në 3 % të limitit të pranimeve në funksione të veçanta, ku kërkohen njohuri specifike, që do të thotë që këto pranime mund të jenë nga radhët e civilëve dhe/ose ushtarakëve, sipas nevojave, duke mos e kaluar limitin 3%.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është kalimi i ushtarakëve në Policinë e Shtetit me vullnetin e këtyre të fundit. Ushtarakët e FA-ve kanë investuar në arsimim, karrierë e status ushtarak. Vullneti i tyre për të ndryshuar rrjedhën e kësaj karriere duhet të jetë i parashikuar qartë në ligj. Formulimi aktual i normës lë vend për të kuptuar një kalim me urdhër të autoritetit ushtarak, ndërkohë që problemi nuk ezaurohet me parashikimin e një marrëveshjeje dy palëshe në nivel ministror. Në këtë kuptim, duke qenë se ligji për statusin e ushtarakut garanton vijimësinë në karrierë të ushtarakut, krahas përfitimeve të tjera, parashikimi i humbjes eventuale të statusit të ushtarakut duhet bërë në përputhje me nenet 3 - 9 të ligjit për statusin e ushtarakut si dhe nenet 25 (para. 1, shkronja "d") dhe 26 (para. 1, shkronja "ç") të ligjit 59/2014 për karrierën ushtarake.

Duhet patur parasysh se ligji për karrierën ushtarake i rezervon ushtarakut të drejtën të ankimojë daljen në lirim ose rezervë, drejtuar MM dhe më pas gjykatës, dhe një vendim eventual i gjykatës për kthimin në FA, është detyrues për zbatim. Në këtë kuptim, projektligji duhet të mbajë parasysh e të rregullojë edhe këtë aspekt, sidomos në rast largimi pa vullnetin e tij të ushtarakut nga FA.

Komisioni për Sigurinë Komëtare bazuar në çështjet e parashtruara, pyetjet e anëtarëve të komisionit dhe përgjigjet e dhëna nga përfaqësuesit e ministrisë propozuese si dhe nga diskutimi nën për nen i projektligjit propozon riformulimet si më poshtë:

IV. RIFORMULIME NEN PËR NEN

- **Neni 1, pas fjalës “policisë” të shtohet fjala “të shtetit” dhe pas pikës 31 shtohet pika 32 dhe neni të riformulohet si më poshtë:**

Neni 1

Pika 16 e nenit 6 të ligjit aktual, ndryshohet si më poshtë:

“16. “Punonjës policie” është personi i emëruar në strukturat e policisë së shtetit pas përfundimit të arsimit/kualifikimit përkatës dhe mban gradë policore.”.

Pas pikës 31 të nenit 6, shtohet pika 32 me këtë përmbajtje:

“Funksione të veçanta” do të konsiderohen ato funksione të cilat nuk ofrohen nga Akademia e Sigurisë.

- **Neni 2 dhe neni 3 i projektligjit hiqen.**
- **Neni 4 i projektligjit rinumërohet si neni 2 i projektligjit dhe përmbajtja e tij nuk ndryshon.**

Neni 2

Pika 1 e nenit 19 të ligjit aktual, ndryshohet si më poshtë:

“1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor. Ajo organizohet mbi bazë shërbimi, e profilizuar në Policinë Kriminale, Policinë për Sigurinë Publike dhe Policinë për Kufirin dhe Migracionin. Kategoritë e profilizuara të Policisë së Shtetit dallojnë midis tyre nga arsimi, kualifikimi, simbolet, detyrat dhe përgjegjësitë që ushtrojnë”.

- **Pika 3 e shtuar në nenin 5 të projektligjit, zhvendoset në nenin 37 të ligjit aktual, pas pikës 2 . Gjithashtu ky ndryshim rinumërohet si neni 3 i projektligjit dhe për rrjedhojë pikat 3, 4 dhe 5 në nenin 37 të ligjit aktual rinumërohen përkatësisht 4, 5 dhe 6, dhe neni ka përmbajtje si më poshtë:**

Neni 3

“ Për nevoja të Policisë së Shtetit, pranohen në Akademinë e Sigurisë, shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të nenit 38 . Kandidati që përfundon me sukses kualifikimin përkatës pranohet në Policinë e Shtetit dhe i jepet grada policore “Nënkomisar”.”.

- **Neni 5 i projektligjit rinumërohet si neni 4 i projektligjit dhe pika 3 kalon si pikë 3 në nenin 37 të ligjit në fuqi; pika 2 e projektligjit hiqet; në shkronjën “g” pas fjalës “të veçanta” të shtohet togfjalëshi “ që lidhen me konkurimin”, duke ndryshuar përmbajtjen e nenit si më poshtë:**

Neni 4

Në nenin 38, bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Shkronja “b”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë:

“b) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil.”.

2. Në pikën 2, pas shkronjës “f”, shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) të plotësojë standardet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurimin, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga ministri i Brendshëm.”.

- **Neni 6 i projektligjit rinumërohet si neni 5 i projektligji dhe përmbajtja e tij nuk ndryshon**

Neni 5

Në pikën 4, të nenit 40, fjalët “... 1 për qind ...” zëvendësohen me “... 3 për qind ...”.

- **Neni 7 i projektligjit rinumërohet si neni 6 i projektligjit; i hiqet titulli; pas fjalës “realizohet” shtohet togfjalëshi “me pëlqimin e ushtarakut”; pas fjalës “struktura” shtohet togfjalëshi “funksionet e veçanta”; në pikën 3 pas fjalës “lirim” shtohet togfjalëshi “nga Forcat e Armatosura” .**

Pas nenit 40 shtohet neni 40/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

1. Për plotësimin e nevojave të veçanta, mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 38, të këtij ligji.
2. Për ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura, pranimi realizohet me pëlqimin e ushtarakut dhe mbi bazë marrëveshjeje dypalëshe, ndërmjet Ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, ku përcaktohen kuotat, strukturat dhe funksionet e veçanta ku do të pranohen.
3. Në çdo rast, pranimi sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet pas nxjerrjes në lirim nga Forcat e Armatosura të ushtarakëve, nga autoritetet kompetente të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
4. Pranimi realizohet mbi baza konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.
5. Kalimi nga strukturat e Forcave të Armatosura te Policia e Shtetit, realizohet duke njohur vjetërsinë e shërbimit.
6. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, miraton ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradat e Policisë së Shtetit.”.

- **Neni 8 dhe neni 9 i projektligjit hiqen.**

Neni 10 i projektligjit rinumërohet si neni 7 .

Neni 7

Pika 1 e nenit 54, të ligjit aktual, ndryshohet si më poshtë:

“1. Fitimi i gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtnes i parë”, bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimim/trajnimit.”.

- **Neni 11 i projektligjit rinumërohet si neni 8 i projektligjit dhe përmbajtja nuk ndryshon.**

Neni 8

Shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 55, ndryshohet, si më poshtë:

“b) të përmbushë kriteret për pozicionin e punës dhe të ketë përfunduar arsimin e lartë.”.

- **Neni 12 i projektligjit rinumërohet si neni 9 i projektligjit dhe përmbajtja nuk ndryshon.**

Neni 9

Në nenin 57 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

1. Në pikën 2, fjalët “... intervista me gojë ...” zëvendësohen me “... në intervistë ...”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë:

“3. Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70 për qind e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Përbërja e komisioneve të gradimit dhe ankimimit, rregullat dhe procedurat e zhvillimit dhe vlerësimit të kandidatëve në fazat e testimit përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.”.

- **Neni 13 i projektligjit rinumërohet si neni 10 i projektligjit dhe përmbajtja nuk ndryshon.**

Neni 10

Në nenin 58 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet dhe bëhet:

“Shpallja e fituesve për procesin e gradimit”

2. Fjalët “... fitimin e gradës përkatëse ...” hiqen.

- **Neni 14 i projektligjit rinumërohet si neni 11 i projektligjit dhe përmbajtja nuk ndryshon.**

Neni 11

Neni 59 ndryshohet, si më poshtë:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë:

“3. Pas përfundimit të programit të arsimimit/trajnimit, renditja e konkurrentëve bëhet sipas shumës së pikëve të arritura gjatë testimit dhe arsimimit/kualifikimit për gradën përkatëse, duke filluar nga punonjësi i cili ka vlerësimin më të lartë.”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

- **Neni 15 i projektligjit rinumërohet si neni 12 i projektligjit dhe përmbajtja nuk ndryshon.**

Neni 12

Pas nenit 59 shtohet neni 59/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 59/1

Dhënia e gradës

Në përfundim të procesit të testimit dhe të arsimimit/kualifikimit, dhënia e gradës bëhet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës. Në urdhër përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.”.

- **Neni 16 i projektligjit rinumërohet si neni 13 i projektligjit, pika 1 hiqet, pika 3 shkronja “b” hiqet togfjalëshi “ose “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, duke ndryshuar për mbajtje e nenit si më poshtë:**

Neni 13

Në nenin 96 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë:

“a) 6 muaj nga njoftimi i masës “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim.”.

2. Shkronja “b”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë:

“b) një vit nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet”.

- **Neni 17 i projektligjit rinumërtohet si neni 14 I projektligjit dhe përmbajtja nuk ndryshon:**

Neni 14
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të nenit 7, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri Brendshëm që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të nenit 7, të këtij ligji.

- **Neni 18 i projektligjit rinumërtohet si neni 15 i projektligjit dhe përmbajtja nuk ndryshon:**

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare

V. KONKLUSIONE

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, me shumicën e anëtarëve miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Relator

Kryetar

Pjerin Ndreu

Ermonela (Felaj) VALIKAJ